



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË
ORGANIZUAR**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 18.07.2025

- Lënda:** Bisedimet përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 660, datë 16.05.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Majlinda Andrea
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 dhe 8 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese

Të nderuar gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit!

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, paşi u shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor të gjitha kërkimet dhe propësimet e palëve, si dhe provat e administruara në kuadër të këtij gjykimi, *Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme*, duke iu qëndruar shkaqeve të ankimit të datës 20.6.2023 dhe parashtrimeve të depozituara në seancën publike të datës 14.7.2025, konstaton se:

1. Në seancën gjyqësore të datës 14.07.2025 në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme i kërkoi Kolegjit të hetojë nëse institucionet e juridiksionit të zakonshëm disiplinor kushtetues kanë ushtruar kompetencën e tyre të kryerjes së hetimit dhe procedimit disiplinor me qëllim shkarkimin e subjektit të rivlerësimit dhe humbjen e statusit të magjistratit.
2. Trupi gjykues i Kolegjit, vendosi të çelë hetimin gjyqësor dhe t'i kërkojë Këshillit të Lartë Gjyqësor informacion si dhe aktet e nxjerra lidhur me mbarimin e statusit të magjistratit për subjektin e rivlerësimit Majlinda Andrea.
3. Në vijim, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, me shkresën nr. ***/* prot., datë **/7.2025, ka përcjellë shkresën nr. **/** regj., datë **/7.2025, të gjyqtarës kryesuese të trupit gjykues të çështjes (JR) nr. 27/2023, datë 04.07.2023, bashkëlidhur së cilës

është përcjellë shkresa nr. ***/* prot., datë ** .7.2025 e Këshillit të Lartë Gjyqësor në të cilën konfirmohet se *“Nga verifikimi i kryer, nuk rezulton asnjë vendimarrje nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbi mbarimin e statusit të magjistratit për subjektin e rivlerësimit znj.Majlinda Andrea”*.

4. Sa më sipër, *Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme*, në kushtet kur institucionet që Kushtetuta i ngarkon me kompetencën e përmbushjes së juridiksionit të zakonshëm disiplinor kushtetues nuk e kanë përmbushur detyrimin e tyre kushtetues dhe janë ende në kushtet e mosveprimit, pa kaluar në përsëritje, duke i qëndruar arsytimit të shkaqeve të ankimit të datës 20.6.2023 dhe parashtrimeve të depozituara në seancën gjyqësore të datës 14.7.2025, vlerëson se për shkak të rolit kushtetues të parashikuar nga paragrafi 5, i nenit 179/b i Kushtetutës, zbatimi i drejtpërdrejt nga ana e Kolegjit i dispozitës së nenit 140/2/a të Kushtetutës, për efekt të kryerjes së procesit të rivlerësimit, do të duhet të sjellë pasojën e deklarimit të përfunduar të procesit të rivlerësimit, pa një vendim përfundimtar për shkak të humbjes së statusit të magjistratit.

I. Kërkimi i ankimit

5. Mbështetur në parashikimin e nenit F, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkojmë që shkaqet e parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe për znj. Majlinda Andrea, në përfundim të gjykimit të çështjes, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 660, datë 16.5.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

- Të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Majlinda Andrea, pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti ka humbur statusin e magjistratit.

DREJTUESI I PROKURORISË

PROKURORI I AUTORIZUAR

Altin DUMANI

Klëdjan BRAHO